GOSNISHTI
AUDITORS & PARTNERS ®

Koment 3

Ne lidhje me pagen maksimale nga 1 Maji 2017

Ne faqen e DPT ka dale njoftimi qe paga maksimale per periudhen Maj 2017 do te jete **105.850** leke, e lidhur kjo me indeksimin e rritjes se pages minimale prej 9%.

Nga nje interesim mora pergjigje per arsyetimin qe: edhe pse nuk ka dale VKM, ligji prevalon, (ligjit 104/2014 date 31.07.2014 ne ndryshim te ligjin 7703 date 11.05.1993 "Per Sig.Shoqerore" , neni 6 qe ndryshon nenin 10), i cili siç e kam theksuar edhe ne komentin e mepareshem thote

"Pas datës 1.1.2015, paga maksimale për efekt kontributi indeksohet në të njëjtën kohë dhe në atë masë që indeksohet paga minimale në shkallë vendi."

Por ne dijenine time eshte pergatitur nje Projekt Vendimi i Keshillit te Ministrave per ndryshimin e VKM 77 date 28.01.2015 ku percaktohet paga maksimale 105.850 leke.

Ne kete projekt eshte parashikuar qe te : " ***Përjashtohen nga pagesa e kontributeve*** *të detyrueshme të sigurimit shoqëror,* ***pensionistët*** *e punësuar dhe të vetëpunësuar në sektorin privat (shtohet pika 10 ne kreun e I-re)*

Pyetja qe shtrohet:

Kjo page do te zbatohet qe me pagat e muajit Maj 2017 apo pas daljes se VKM-se?

DPT thote qe nga muaji Maj, çdo arsyetim te metejeshem une do ta vleresoja humbje kohe.

Me poshte njoftimi i DPT si tekst dhe me PrintScrin

Njoftim për pagën minimale dhe maksimale nga periudha Maj 2017

Të nderuar tatimpagues!

Ju bëjmë me dije se, duke filluar nga **periudha Maj 2017**, paga bazë minimale mujore, në shkallë vendi për punonjësit, e detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo person juridik apo fizik, vendas apo i huaj, është 24,000 lekë. (VKM nr.399, datë 03.05.2017)

Për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, paga bruto mujore, do të jetë:

1. Jo më pak se sa paga minimale mujore, e barabartë me **24,000** (njëzet e katër mijë) lekë dhe deri në **105,850** (njëqind e pesëmijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë, për personat e punësuar;
2. Jo më pak se paga minimale, e barabartë me **24,000** (njëzet e katër mijë) lekë dhe sipas përcaktimit të vetë personit, deri në **105,850** (njëqind e pesëmijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë, për personat e vetëpunësuar;
3. E barabartë me pagën minimale mujore prej **24,000** (njëzet e katër mijë) lekë, për punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuari punon e bashkëjeton ligjërisht.

Gjithashtu, paga minimale në shkallë vendi prej 24,000 lekë, shërben edhe për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve të detyrueshme të sigurimit shëndetësor.

Ju faleminderit!



Nxjerre 01.06.2017